

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nga DEFZH-ja, nr.-IV-334, të dt.15.04.2022, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja nr.-I-36, e dt.25.02.2009 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për biznese në Komunën e Obiliqit.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesueses
- Nënkryetarit
- MAPL
- DEFZH
- Anëtarëve të KK
- Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

**RREGULLORE (KO) NR. I/2022 PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E
ORARIT TË PUNËS SË BIZNESEVE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

Obiliq, Prill 2022

Në bazë të nenit 11 dhe 12 paragrafi 12.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, nr.2004/18, dispozitave të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme, nr.04/L-005, dispozitat e nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje, nr.05/L-087, Nenit 22 të Ligjit Për Mbrojtje nga Zhurma me nr.2/L/102 në mbështetje edhe të nenit 38 pika -1/3 nenit 83.pika 7, nenit 89 të Statutit të Komunës së Obiliqit , nr.-I-34/2016 të datës 25/04/2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit , në seancën e vet të rregullt të 4 më radhë për vitin 2022, të mbajtur më 28/ 04 /2022, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËRFILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË

BIZNESEVE NË KOMUNËN E OBILIQIT

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera: hoteleri, zejtari, prodhimtari dhe shërbime tjera të organizimit afarist dhe biznesorë në territorin e Komunës së Obiliqit .

Neni 2

PërkufizimetPërkufizimet dhe termat që përdorën në këtë Rregullore janë të përcaktuara dhe të qartësuara në dispozitën e nenit 2 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, nr. 2004/18, si dhe nenit 1. të Ligjit nr. 04/L-005 për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme.

Neni 3

Orari i punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar më këtë Rregullore, duke përfshirë edhe kohën e pushimeve ditore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit.
3. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.
4. Për arsye të jashtëzakonshme, si dasma, vdekje, fatkeqësi të ndryshme etj, bizneset që nuk punojnë duhet që informacionin përkatës detal ta vënë në vend të dukshëm të biznesit.

Neni 4

Respektimi i orarit të punës

Bizneset dhe veprimtaritë tjera afariste, në pajtim më nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar më këtë Rregullore.

Neni 5

Periudha e llogaritur verore dhe dimërore

1. Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore të kohës, në intervale kohore:
 - 1.1. Periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit,

1.2. Periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit.

ORARI I PUNËS SIPAS VEPRIMTARIVE AFARISTE-EKONOMIKE

Neni 6

Veprimtaritë e dyqaneve zejtare dhe shërbyese

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në dyqanet zejtare dhe ato shërbyese, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00,
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 19:00.

2. Gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë të javës:
 - 2.1. Periudha verore, prej orës 6:00 - 22:00,
 - 2.2. Periudha dimërore prej orës 7:00 - 21:00.

3. Ditën e diele dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve dhe pikave të shitjes së shtypit ditor.

4. Pishinat gjatë periudhës verore punojnë nga ora 8:00 deri në ora 20:00, ndërkaq për zgjatjen e orarit të punës bëhet pagesa 10,00 euro për çdo orë të zgjatur të punës, sipas procedurës tek Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe lejes së veçantë të saj, si tek rastet e tjera të zgjatjes së orarit të punës.

5. Institucionet bankare, kompanitë e sigurimeve dhe agjencitë turistike fillojnë me punë në ora 8:00 deri në ora 17:00, ndërkaq ditën e diele nuk punojnë.

6. Furrat e bukës punojnë çdo ditë në të dy sezonet, duke filluar prej orës 7:00 e deri në ora 23:00.

7. Nëse kërkohet orar më i zgjatur veprohet si në pikën 4 të këtij neni.

Neni 7

Qendrat tregtare, marketet, vetëshërbimet dhe dyqanet tjera tregtare ushqimore dhe jo ushqimore

1. Orari i punës në qendra tregtare, vetëshërbime, minimarkete, supermarketete, hipërmarketedhe dyqane ushqimore, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00,
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 – 23:00.

2. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstitit, dyqanet e këpucëve, libraritë, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore, do të jetë:
 - 2.1. Periudha verore, prej orës 7:00 – 21:00,
 - 2.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 20:00.

3. Ditën e fundjavës (të dielave) të gjitha veprimtarit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, orari i punës do të fillojë nga ora 09.00 dhe do të mbaroj në ora 18.00 . Këto veprimtari nga natyra e punës dhe me leje të posaçme të cilën e lëshon DEFZH-ja mund të punojnë deri në ora 23.00.

4. Veprimtarit si nga paragrafi 1 i këtij neni mund te punojnë të dielën e fundit para festave: bajramit, pashkëve, krishtlindjeve dhe vitit te ri;

Neni 8

Ndërmarrjet prodhuese, ndërtimore dhe depot tjera

1. Orari i punës në depo të artikujve ushqimorë, depo të materialit ndërtimor, ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, si dhe të ndërmarrjet tjera prodhuese, do të jetë:
 - 1.1. Periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00,
 - 1.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.

2. Ditën e diele dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.

3. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:

- 3.1. Periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00,
 - 3.2. Periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.
4. Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës kontinueletë punëve, me leje të veçantë, të cilën e lëshon Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit - Sektori i Ekonomisë, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.
 5. Paguesa është 10,00 euro për orë pune të zgjatur.

Neni 9

Veprimtaritë hoteliere: motelet, restorantet dhe kafenetë

1. Orari i punës në hotele, motele, do të jetë 00:00-24:00, dhe do të jete e njëjte për të dy sezonet.
2. Tek hotelet dhe motelet mund të punojnë pa ndërprerë vetëm me shërbimin e recepcionit (bujtinat, fjetjet) por duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera .
3. Orari i punës në restorante, kafene është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 7:00 - 24:00.
4. Gjatë periudhës verore (15 korrik – 15 shtator) orari i punës, si nga paragrafi 2 i këtij neni mund të vazhdohet deri në ora 2:00 të mëngjesit, duke respektuar dispozitat përkatëse të Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma.
5. Për zgjatjen e orarit sipas paragrafit 4, bizneset duhet të marrin pëlqim për tërë sezonin brenda një viti, pranë Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
6. Përgjashtim nga paragrafi 1. 2. 3. 4 i këtij neni, bëjnë objektet hoteliere të cilat gjinden në afërsi të objekteve të banimit në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio-video, programi nuk mund të mbahet pas orës 23:00.

7. Për tu pajisur me Pëlqim nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim duhet të bëhet kërkesë për zgjatjen e orarit të punës 72 orë më herët, ndërsa me Aktvendim për zgjatjen e orarit të punës DEFZH-ja njofton Inspektorët Komunal dhe Stacionin Policor në Obiliq 48 orë më parë.
8. Veprimtaritë e lartcekura të nenit 9 në zgjatjen e orarit të punës ku mund të përdoret muzika, Inspektorët Komunal me vendim përcaktojnë se zhurma nga mbajtja e muzikës nuk tejkalon nivelin e lejuar në mjedise, sipas ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr.02/L-102. Mbikqyrjen për aplikimin e këtij ligji dhe akteve plotësuese normative që dalin nga ky ligj, e kryejnë Inspektorët komunal të Mjedisit.
9. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë në vlerë prej 10 € për orë pune shtesë.
10. Veprimtarive të lartpërmendura, nuk iu lejohe shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 24:00.

Neni 10

Veprimtaritë e kafe-bareve, disko-klubet, internet-kafet dhe fitneset

1. Orari i punës në kafe-bare dhe disko-klube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 7:00 dhe mbaron në orën 24:00;
2. Orari i punës në kafe-bare dhe disko-klube, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 7:00 dhe mbaron në orën 23:00 në zonat urbane të qytetit;
3. Orari i punës për klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 21:00 dhe mbaron në orën 2:00 (të mëngjesit);
4. Orari i punës për internet - kafe dhe fitneset, fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00.

Neni 11

Stadiumet dhe palestrat sportive

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive punojnë sipas orarit.

Orari i punës 9:00 deri në ora 24:00 është i njëjtë në dy sezonet.

Neni 12

Ruajtja e rendit dhe qetësisë

1. Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9, 10 dhe 11 të kësaj Rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejonet në çfarëdo forme, të prishin qetësinë e qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.
2. Çështja e zhurmës përligjohet dhe sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen nga zhurma, nr.02/L-102 (neni 25).

Neni 13

Objektet hoteliere afër vendbanimit

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi deri në 100 metra nga objektet e banimit, në të cilat organizohet program me muzikë të gjallë apo me audio-video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të vazhdojë pas orës 24:00.

Neni 14

Veprimtaritë e tregjeve

1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:
 - 1.1. periudha verore, prej orës 6:00 – 19:00,
 - 1.2. periudha dimërore, prej orës 7:00 – 18:00.
2. Tregu i gjelbër dhe ai i sendeve të tjera tregtare (si ditë tregu) punon ditën e hënë ndërkaq nuk do të punojnë ditëve të festave, të përcaktuara më ligjin përkatës.
3. Tregu i kafshëve punon ditën e hënë, po ashtu tregu i automjeteve ditën e hënë, ndërkaq edhe këto tregje nuk punojnë ditëve të festave.

Neni 15

Pikat e Shitjes së karburanteve

1. Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve është i njëjtë në të dy sezonet dhe zgjatë 24orë pandërprerë.
2. Orari i punës në pikat e shitjes së karburanteve në zonat rurale punojnë prej orës 06.00 deri ne ora 23.00 dhe është i njëjtë në të dy sezonet.
3. Baret (Kafenetë) si pjese përbërëse të pikave te shitjes së karburanteve, funksionojnë sipas nenit 9 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje.

Neni 16

Veprimtaritë e barnatoreve, ordinancave dhe klinikave private

1. Orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orës 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.
2. Disa ordianca apo klinika private punojnë sipas kushteve me orar të shkurtuar, duke e shfrytëzuar kohën pas përfundimit të orarit zyrtar. Këto veprimtari duhet të vendosin orarin e shkurtuar ne derën e ordinancës respektivisht të klinikës.

3. Barnatoret dhe laboratorët që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve kryesore mjekësore, në harmoni me planin për kujdestari (nga ora 22:00 deri 07:00) të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Sektorin e Ekonomisë pranë Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit do të kenë kujdestarinë 24 orë pa ndërprerë në baza mujore, apo sipas marrëveshjes në koordinim me barnatoret humane .
4. Orari i kujdestarisë do të publikohet në QKMF-Obiliq, në barnatore, web-faqen zyrtare të Komunës, po ashtu orari i kujdestarisë do të prezantohet Drejtorisë së Inspektionit dhe Stacionit policor Obiliq.
5. Në raste urgjente, ditën e diele dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë, sipas neni 16 paragrafi 1, pas marrjes së lejes së veçante nga DEFZH në përputhje me planin e DSHMS-së.
6. Barnatoret që veprojnë në qytet, në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Sektorin e Ekonomisë, apo Zyrën tjetër kompetente të Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, do të kujdestarojnë ditën e diel dhe gjatë festave, sipas renditjes - rotacionit të hartuar në bashkëveprim me DEFZH-në dhe DSHMS-në.

Neni 17

Orari i punës gjatë festave zyrtare dhe shtetërore

1. Bizneset mund të punojnë dhe ta zgjasin orarin e punës, deri në orën 01:00 (të mëngjesit), më rastin e festave të parapara më Ligjin për Festat zyrtare.
2. Për rastet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

Neni 18

Rastet e veçanta

1. Në raste të veçanta nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, e me kërkesë të subjekteve biznesore dhe me miratimin e vendimit të veçantë të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, mund të përcaktohet orari tjetër i punës apo edhe orari 24 orë pandërprerë i punës.
2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

3. Rastet e kujdestarisë së punës të subjekteve biznesore përcaktohen me vendim të veçantë të organit nga neni 18 pika 18.1 e kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Tërheqja e lejes

Të gjitha bizneset të cilat marrin leje të veçantë për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, do t'u merret leja e punës e lëshuar nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit - Resori kompetent i Ekonomisë.

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 20

Gjobat kundërvajtëse

1. Me gjobë për kundërvajtje do të gjobitën bizneset të cilat veprojnë në kundërshtim me nenet 5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15 dhe 16, të kësaj rregulloreje dhe atë si në vijim:
 - 1.1. Personat fizik..... 50 – 100 €
 - 1.2. Personi përgjegjës i personit juridik..... 50 - 200 €
 - 1.3. Personat juridik..... 200- 1000 €

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 21

Përgjegjësit e zbatimit të kësaj rregulloreje

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset: Drejtoria e Inspektoratit - Inspekcioni kompetent, Drejtoria përEkonomi, Financadhe Zhvillim, Policia si dhe Gjykata Themelore në Prishtinë -Divizioni për Kundërvajtje.

Neni 22

Harmonizimi i orarit të punës

Të gjitha bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 23

Veprimtaritë e paparapara

Nëse ndonjë veprimtari, ose çështje lidhur me caktimin e orarit të punës nuk është e përfshirë me këtë Rregullore ose në rast të ndonjë zbrazëtire tjetër juridike, do të vlejë dhe do të zbatohen drejtpërsëdrejti dispozitat përkatëse të Ligjit për Tregtinë e Brendshme së bashku me ndryshimet e tij, ligjeve të tjera që përligjojnë çështjen e orarit të punës së bizneseve dhe afarizmit, si dhe dispozitat e Udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 24

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Obiliqit, nr.01/36/2009, e miratuar me datën 25.02.2009

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjete (15) dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit

KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT

01 Nr. _____/2022

Obiliq , dt. 28 / 04 /2022

